# “Nxitoni (për ta dërguar në varr) xhenazen, sepse nëse ka qenë vepërmirë, e dërgoni në mirësi, e, nëse nuk ka qenë i tillë, atëherë është një barrë që e hiqni prej supeve tuaja.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Nxitoni (për ta dërguar në varr) xhenazen, sepse nëse ka qenë vepërmirë, e dërgoni në mirësi, e, nëse nuk ka qenë i tillë, atëherë është një barrë që e hiqni prej supeve tuaja.”
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith urdhëroi që të nxitohet në përgatitjen e xhenazes, faljen e namazit të saj dhe varrosjen e saj. Nëse i ndjeri është vepërmirë, atëherë është një e mirë që po e çoni drejt mirësisë së varrit. Nëse është ndryshe, atëherë është një barrë e keqe, që po e hiqni nga supet tuaja.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3109